



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 1 prill 2019

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121; në mbështetje të rregullit 21 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; në mbështetje të nenit Neni 25 pika 2.a, e Rregullores Nr. 02/2018 të Njesisë Ligjore, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese shpall:

KONKURS
të brendshëm për plotësimin e vendit të punës nëpërmjet procedurës së avancimit

Pozita: Këshilltar i lartë Kushtetues Juridik për Administrim dhe Filtrim të Kërkesave
Kodi: GJ-DL-18-19
Numri i vendeve të punës: 1 (një)
Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:

Nën mbikëqyrjen e Këshilltarit të Parë të lartë Kushtetues Juridik, mbështet punën profesionale të këshilltarëve juridikë të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim të sigurimit të funksionimit efikas dhe efektiv të Njesisë Ligjore.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Zhvillon takime me parashtruesit e kërkesave;
2. Kontrollon dokumentacionin e paraqitur në kërkesë dhe udhëzon Parashtruesit për plotësimet e nevojshme;
3. Përgatitë dhe plotëson formularin standard të filtrimit për kërkesat e regjistruara;
4. Jep sugjerime (indikacione) për ndjeshmërinë e rastit konkret të pranuar në Gjykatë;
5. Përgatitë raportin javor për Kryetaren e Gjykatës lidhur me kërkesat e arritura brenda javës;
6. Raporton në Njesisë Ligjore lidhur me numrin dhe natyrën e rasteve të pranuar në Gjykatë;
7. Përpilon procesverbalin për këshillim e votim;
8. Përgatitë raporte të veçanta për nevoja të Njesisë Ligjore;
9. Përgatitë raportin për përmbushjen e kriterëve pasi të jetë gati vendimi për publikim;
10. Plotëson dhe përditëson statistikat e rasteve në folderin e Njesisë Ligjore;
11. Kryen dhe punë tjera me kërkesë të Këshilltarit të parë të Lartë Kushtetues Juridik;

Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme:

- Përgatitja Universitare në Shkencat Juridike; dhe,
- Pesë (5) vjet përvojë pune profesionale juridike;
- Njohuritë e gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës dhe gjuhës Angleze.

Këshilltari i Lartë Kushtetues Juridik për Administrim dhe Filtrim të Kërkesave duhet të posedojë aftësi për të ndërmarrë iniciativë dhe për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrje minimale, si dhe duhet t'i u kushtojë vëmendje të kujdesshme hollësive; të ketë aftësi për të krijuar dhe për të mbajtur marrëdhënie të mira në punë, si pjesëtar i ekipit në një mjedis shumë kulturor dhe shumetnik; të ketë aftësi të mirë ndër personale dhe të komunikimit; të tregojë përkushtim ndaj cilësisë; të ketë aftësi për të kryer punët dhe detyrat në situata stresi; të ketë gatishmëri për të punuar me orar fleksibil; të ketë aftësi organizative; të ketë aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, veçanërisht të programeve MS Word dhe Excel; si dhe të ketë aftësi të zhvilluara për hartimin e dokumenteve.

Procedura e konkurrimit

I brendshëm (Avancim)

Procedura e konkurrimit është e hapur për gjithë personelin kushtetues administrativ ekzistues në Gjykatën Kushtetuese të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të avancimit për gjithë personelin ekzistues brenda Gjykatës.

Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Rregullores së punës Nr. 01/2018 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 të Njësisë Ligjore.

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org.

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: lulzim.syla@gjk-ks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese (DABNJ) në kopje fizike.

Konkursi i brendshëm mbetet i hapur 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Gjykatës dhe në tabelën e shpalljeve, duke filluar nga data 01/04/2019 deri më datën 05/04/2019, që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 05 prill 2019, deri në ora 16.00.

Shënim:

Aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.